

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6535
E hënë, 14 shkurt 2022
çmimi 0.40

Vazhdojnë rastet e vdekjes dhe infektimit nga Covid, bëhet thirrje për vaksinim

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON RITJA E ÇMIMEVE NË KOSOVË | FAQE 4-5

RRITEN ÇMIMET NË TË GJITHË SEKTORËT, OPOZITA KËRKON NDËRHJRJEN E QEVERISË



Deputetët e partive opozitare kanë kërkuar nga qeveria që të reagojë ndaj situatës së ngritjes së çmimeve të konsumit. Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka propozuar që të lejohet edhe një tërheqje tjetër nga trusti. Kurse deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kërkuar që të rriten subvencionet për bujqësinë. Sipas tyre, këto veprime do t'u ndihmonin qytetarëve ta përballojnë më lehtë situatën aktuale për shkak të krizës ekonomike dhe rritjes së çmimeve në të gjithë sektorët

AKTUALE



BIDENI: PUSHTIMI I UKRAINËS DO TË SHKAKTONTË VUAJTJE TË MËDHA F. 2

STEINMEIERI RIZGJEDHET PRESIDENT I GJERMANISË F. 2

SHQIPËRIA U KËRKON SHTETASVE SHQIPTARË TË LARGOHEN NGA UKRAINA F. 3



Kryetarët e komunave kërkojnë të paguhen sa deputetët dhe ministrat

FAQE 2



ISH-PRESIDENTI MESIQ: SERBIA PO VAZHDON FUSHATAT LOBUESE PËR ÇNJOHJEN E KOSOVËS

FAQE 3

EKONOMI



SI TË DILET JASHTË ME "MADE IN KOSOVA"? F. 7

SPORT



MALISHEVA MPOSHTI PRISHTINËN, DRITA MERR KRYESIM NË TABELË F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni: Pushtimi i Ukrainës do të shkaktonte vuajtje të mëdha

UASHINGTON, 13 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, i tha presidentit rus Vladimir Putin se pushtimi i Ukrainës nga ana e Rusisë “do të shkaktonte vuajtje të mëdha për njerëzit” dhe “do ta zvogëlonte pozitën e Rusisë” në botë. Shtëpia e Bardhë bëri këtë njoftim pas bisedës telefonike që zhvilluan dy presidentët të shtunën. Bideni përsëriti se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre do të “përgjigjeshin me vendosmëri” nëse Rusia pushton.

Ai tha se reagimi i aleatëve do të kishte “kosto të shpejta dhe të rënda për Rusinë”. “Shtetet e Bashkuara mbeten të përgatitura për

t’u angazhuar në diplomaci, por ne jemi po aq të përgatitur për skenarë të tjerë”, ka paralajmëruar Biden.

Telefonata, e cila zgjati rreth një orë, nuk shkaktoi ndonjë ndryshim thelbësor në tensionet në mes të Rusisë dhe Ukrainës, tha një zyrtar i lartë i administratës amerikane që foli me gazetarët.

Mbetet e paqartë nëse Rusia është e gatshme ta ndjekë rrugën diplomatike, tha ai, duke shtuar se Rusia mund të vazhdojë me veprime ushtarake.

Rusia tash e sa muaj ka grumbulluar mbi 100 000 trupa në kufi me Ukrainën, por ka mohuar se ka plane për pushtim. Sipas Rusisë,



NATO-ja është ajo që paraqet kërcënim për sigurinë e saj.

Shteti rus ka kërkuar garanci nga NATO-ja se do ta

ndalojë zgjerimin drejt Lindjes dhe se nuk do të pranojë në radhët e saj vendet ish-sovjetike, përfshirë Ukrainën.

ShBA-ja dhe NATO-ja kanë refuzuar kërkesat ruse për zgjerimin, por kanë ofruar rrugë diplomatike për zgjidhjen e krizës.

Osmani: Duhet mençuri dhe jo emocione në kontestin me Bullgarinë



SHKUP, 13 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, të dielën [13 shkurt] paralajmëroi shtim të bisedimeve me Bullgarinë për zgjidhjen e kontestit që po mban të bllokuar nisjen e bisedimeve të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian që nga nëntori i vitit 2020. Ai tha se pas datës 17 shkurt do të ketë takime të më shumë grupeve punuese, përfshirë ato për tekstet shkollore, kulturën dhe integrimin evropian.

Osmani tha se qëndrimet e palës maqedonase mbeten të pandryshuara sa iu përket çështjeve që kanë të bëjnë me gjuhën dhe identitetin, që janë edhe thelbi i kontestit meqë Sofja insiston që Shkupi të pranojë që ata kanë “rrënjë bullgare” deri në vitin 1945. “Qëndrimet tona shtetërore janë

të qarta dhe nuk ka ndryshime. Çështjet më të rëndësishme për ne janë çështjet identitare në kornizën e negociatave si zgjidhje evropiane. Është çështja e të drejtave të komunitetit bullgar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe, në njëfarë mënyre, kjo identifikon rrugën që duhet të marrë ky proces”, ka deklaruar Osmani. Sipas tij, hapja e Kushtetutës dhe njohja e bullgarëve si minoritet në Maqedoni është pjesë e politikës shtetërore ndaj komuniteteve etnike. Ai tha se nëse nuk ka asgjë të diskutueshme për njohjen e malazezëve dhe kroatëve si minoritet, atëherë pse të ketë problem në kërkesën për përfshirjen në Kushtetutë të qytetarëve bullgarë.

Osmani tha se në dialogun me Sofjen nevojitet të vepohet “me kokë të ftohtë e zemër të

nxehtë”. “Qëllimi im përfundimtar është që Maqedonia e Veriut të bëhet një vend evropian, t’i normalizojë marrëdhëniet me fqinjët, duke ruajtur atë që është më e rëndësishme për qytetarët. Për këtë na duhet më shumë mençuri në veprim sesa emocione... Por qytetarët mund të jenë të qetë se nuk do të lejojmë që të cenohet asgjë që është thelbësore për identitetin e tyre”, ka deklaruar ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani.

Qeveritë e dy vendeve më 25 janar në Sofje kanë formuar disa grupe të punës të cilët në gjashtë muajt e ardhshëm duhet t’i vendosin bazat e bashkëpunimit ekonomik në më shumë sfera, që më pas t’i qasen edhe thelbit të problemit që ka të bëjë me çështjen e gjuhën dhe të identitetit.

Steinmeier rizgjedhet president i Gjermanisë

BERLIN, 13 SHKURT - Frank Walter Steinmeier është rizgjedhur për mandatin e dytë në postin e presidentit të Gjermanisë. Votimi për president u mbajt në Asamblenë Federale në Berlin. Atë e propozuan për mandatin e ri partitë

qeveritare SPD, të Gjelbrit dhe FDP, si dhe opozita CDU/CSU. Së bashku ato kishin një shumicë të madhe. Ai u zgjodh në këtë post me 1 045 vota. Nga 1 437 vota, 1 425 qenë të vlefshme, 12 të pavlefshme, 86 abstenime.

Steinmeier tha se do të jetë president mbipartiak, por jo neutral kur është fjala për demokracinë. “Ai që angazhohet për demokracinë, më ka në anën e tij. Ai që është kundër saj, më ka kundër”, tha ai.



Ish-presidenti Mesiq: Serbia po vazhdon fushatat lobuese për çnjohjen e Kosovës



Ish-presidenti kroat Stipe Mesiq gjatë vizitës së tij në Kosovë u ka thënë liderëve të institucioneve të Kosovës, se Serbia po vazhdon fushatat lobuese për çnjohjen e Kosovës. Ai ka kërkuar nga ta angazhim të shtuar në rrafshin ndërkombëtar për ta ndaluar këtë fushatë të Serbisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 SHKURT - Ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiq, ka vizituar të dielën veriun e Mitrovicës. Vizita e tij është bërë nën masa të rrepta të sigurisë. Eskorta e tij për një çast ka ndaluar në qendër duke thënë se kishte ardhur për vizitë dhe se jugu e veriu janë një dhe po ndihet shumë mirë.

I pyetur nga mediet nëse po ndihej i sigurt për shkak të pranisë së shtuar të forcave policore, Mesiqi tha se “edhe sikur të isha vetëm do të ndihesha njëjtë, shumë i sigurt”. “E dini, unë jam kureshtar. Kam dashur të shoh si njëjërën ashtu edhe Mitrovicën tjetër. Në fakt, bëhet fjalë për një Mitrovicë. Po shoh se gjithçka është në rregull dhe qetë. Unë do të isha i sigurt sikur të kisha ardhur edhe vetëm këtu”, ka thënë Mesiq. Sipas tij, kontrolli i plotë i territorit nga ana e institucioneve të Kosovës do të varet nga marrëveshja e përgjithshme.

Mesiqi theksoi se luftë nuk do të ketë më dhe njerëzit duhet të bashkëpunojnë mes vete, sepse vetëm kështu të gjithë do të jenë të kënaqur. “Gjithçka varet

nga marrëveshja. Lufta ka lënë pasojat e saj, duhet të gjithë ta kuptojnë se luftë nuk ka dhe nuk do të ketë, dhe njerëzit duhet të bashkëpunojnë sepse vetëm kështu të gjithë do të jenë të kënaqur”, tha ish-presidenti kroat Mesiq.

Një ditë më parë Mesiqi, i cili ishte i shoqëruar edhe nga ish-presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, është pritur edhe nga krerët më të lartë të shtetit si presidentja Osmani, kryekuvendari Konjufca si dhe kryeministri Kurti.

Presidentja Vjosa Osmani ka falënderuar ish-presidentët Mesiq dhe Topi për angazhimin e tyre të vazhdueshëm personal në mbështetje të Republikës së Kosovës si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë.

Gjatë takimit u theksua se raportet e ngushta ndërshtetërore në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë janë ndërtuar mbi themele të forta historike dhe respekt të ndërsjellë tradicional në mes të kombit shqiptar dhe atij kroat.

Në këtë takim presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë

ndërmjet tri shteteve përballë sfidave rajonale dhe globale dhe në funksion të stabilitetit dhe avancimit të agjendave euro-atlantike në Ballkanin Perëndimor.

Presidentja Osmani shprehu besimin e saj se ish-presidentët Mesiq dhe Topi do të vazhdojnë të jenë avokues për Republikën e Kosovës në qarqe dhe forume ndërkombëtare ku ata marrin pjesë.

Edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i ka uruar mirëseardhje në vendin tonë Mesiqit, duke e cilësuar mik të sinqertë i cili ka shprehur gjithmonë përkrahjen e tij për Kosovën. Ai i shprehu mirënjohje Kroacisë mike për mbështetjen e gjithanshme që i ka dhënë vendit tonë. “Dy vendet tona, si partnere strategjike, kanë marrëdhënie të forta miqësie dhe bashkëpunimi në shumë fusha me interes të përbashkët, përfshirë edhe atë të legjislativit”, vuri në pah Konjufca.

Sipas kryetarit Konjufca, Kroacia ishte dhe do të jetë edhe më tutje mbështetëse e fuqishme e Kosovës në rrugën e saj të integritetit në Bashkimin Evropian dhe në strukturat euroatlantike. Ai njëherësh e

falënderoi ish-presidentin kroat për kontributin e tij të pazëvendësueshëm për shtetndërtimin e vendit tonë dhe rikujtoi se gjatë presidencës së Mesiqit Republika e Kroacisë e njohu pavarësinë e Kosovës, duke krijuar marrëdhënie të shkëlqyeshme të miqësisë dhe bashkëpunimit. “Jeni gjithmonë i mirëpritur dhe Kosovën mund ta konsideroni si shtëpinë tuaj”, u shpreh kryetari Konjufca.

Ish-presidenti kroat dhe autori i librit “Si është rrënuar Jugosllavia”, Stipe Mesiq, pasi falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen e përzemërt, riktheu në kujtesë ngjarjet që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe përballjet e tij për Kosovën me kryekriminelin Slllobodan Millosheviq. “Jugosllavia ka mundur të shpërbëhet pa luftë, por politika shoviniste e Millosheviqit ishte ajo që u shkaktoi tragjedi popujve joserbë në këto hapësira. Ai mendonte se do të arrinte ta gënjente botën për ‘të drejtën serbe’, por gënjeu veten dhe serbët. Serbët vazhdojnë ta urrejnë Millosheviqin jo pse shkaktoi gjithë ato luftëra të përgjakshme, por pse i humbi ato”, tha Mesiqi, duke premtuar se do të vazhdojë të jetë zë i fuqishëm i kudondodhur në përkrahje të aspiratave integruese të Republikës së Kosovës.

Mesiqin dhe Topin i ka pritur në takim edhe kryeministri Kurti, i

cili ka falënderuar për vizitën, për angazhimin dhe përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën.

Duke folur për qeverisjen rreth njëvjeçare, kryeministri Kurti tha se prijme në rajon për menaxhimin e mirë të pandemisë, me vaksinimin e tashmë dy të tretës së popullatës së rritur. Ai i njoftoi edhe për rezultatet e shënuara në ekonomi.

Dy ish-presidentët e përgëzuan kryeministrin Kurti për detyrën dhe sukseset në qeverisjen e deritanishme. Ata shprehën besimin që ai do ta vazhdojë ta kryejë me përgjegjësi e kompetencë detyrën që ia kanë dhënë qytetarët.

Ish-presidenti Topi theksoi nevojën për më shumë bashkëpunim rajonal dhe koordinim më të mirë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, sidomos me institucionet e Bashkimit Evropian, përfshirë këtu çështjen e liberalizimit të vizave.

Ish-presidenti kroat, Mesiq, tha se duhet angazhim i shtuar në rrafshin ndërkombëtar sepse, siç tha ai, Serbia po vazhdon fushatat lobuese për çnjohjen e Kosovës.

Lidhur me dialogun me Serbinë, kryeministri Kurti tha se është proces që duhet të ketë në qendër njohjen e ndërsjellë, drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve.



Vazhdon rritja e çmimeve në Kosovë

Rriten çmimet në të gjithë sektorët, opozita kërkon ndërhyrjen e qeverisë

Deputetët e partive opozitare kanë kërkuar nga qeveria që të reagojë ndaj situatës së ngritjes së çmimeve të konsumit. Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka propozuar që të lejohet edhe një tërheqje tjetër nga trusti. Kurse deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kërkuar që të rriten subvencionet për bujqësinë. Sipas tyre, këto veprime do t'u ndihmonin qytetarëve ta përballojnë më lehtë situatën aktuale për shkak të krizës ekonomike dhe rritjes së çmimeve në të gjithë sektorët

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 13 SHKURT - Pas rritjes së çmimeve të konsumit kanë reaguar deputetët e opozitës. Ata kanë kërkuar ndërhyrjen e qeverisë për ta lehtësuar gjendjen e qytetarëve të Kosovës.

Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka propozuar tërheqjen e mjeteve financiare për qytetarët nga Trusti Pensional deri në 30 për qind. Ndërsa ish-kryeministri Avdullah Hoti ka

thënë se qeveria duhet t'i rritë subvencionet për 25 për qind. I pari ka thënë se propozimin e tij për qeverinë e ka bërë pas kërkesës së shumë qytetarëve. "Pas shtrenjtimit të rrymës dhe të gjitha produkteve të konsumit ditore është mëse e nevojshme që qeveria ta sjell në votim propozimin tim për tërheqjen e Trustit Pensional deri në 30 për qind. Propozim-amandamenti im do të ndikojë në rimëkëmbje ekonomike dhe mbështetje për qytetarët", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e

vet në "Facebook".

Më tej, ai ka specifikuar se si duhet të konkretizohet ky propozim. "1. Personat që kanë kursime pensionale në shumën më pak se 10.000 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në tridhjetë për qind (30%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK. 2. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 10.000 euro deri në 19.999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në njëzetepesë për qind (25%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK. 3. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 20.000 euro deri në 29.999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në njëzet për qind (20%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK", ka propozuar ai, duke përmendur edhe dy kategori të tjera. "4. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 30.000 euro deri në 39.999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në pesëmbëdhjetë për qind (15%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK. 5. Personat që kanë kursime pensionale me shumë se 40.000

euro (dyzet mijë), kanë të drejtë t'i tërheqin deri në dhjetë për qind (10%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK", ka shkruar Haxhiu.

Me këtë propozim, sipas deputetit të PDK-së, qytetarët që kanë të ardhura më të ulëta do të mbështeten më shumë, kurse ata që kanë më pak mjete në Trust t'u lejohet të tërheqin më shumë mjete me qëllim që ta përballojnë më lehtë situatën aktuale për shkak të krizës ekonomike dhe rritjes enorme të çmimeve në të gjithë sektorët pa dallim.

Qeveria t'i rritë pensionet

Edhe ish-kryeministri Avdullah Hoti ka dhënë të dielën një propozim për Qeverinë e Kosovës. Deputeti i LDK-së ka kërkuar nga qeveria t'i rritë subvencionet për së paku 25 për qind. Sipas tij, nëse kjo nuk ndodh, ky vit do të jetë i vështirë për bujqit. "Viti 2022 do të jetë i vështirë për bujqit nëse qeveria nuk i rrit subvencionet së paku për 25 %. Sipas Agjencisë së Statistikave, çmimet e inpueteve

bujqësore, ku hyjnë farërat, plehrat, pesticidet, ushqimi i kafshëve dhe të ngjashme, në tremujorin e fundit të vitit 2021 janë rritur me 25.3% krahasuar me një vit më parë. Për plehrat dhe ushqimin e kafshëve në veçanti, rritja e çmimeve ka qenë shumë më e lartë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se me këtë rritje të çmimit të inpueteve bujqësore bujqit do ta kenë të vështirë të mbajnë nivelin e prodhimit si në vitin paraprak. "Kjo do të ndikojë në rënien e të ardhurave të mijëra familjeve që aktivitet kryesor e kanë bujqësinë. Efekti negativ do të jetë zinxhiron, pasi do të rritet importi i produkteve bujqësore dhe do të përkeqësohet aftësia konkurruese e prodhuesve kosovarë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Qeveria urgjentisht duhet të rrisë subvencionet për bujqësi së paku për 25 % për të ruajtur nivelin ekzistues të aktivitetit bujqësor në vend. Po aq e rëndësishme për bujqit është që subvencionet të paguhet në

Shqipëria u kërkon shtetasve shqiptarë të largohen nga Ukraina

TIRANË, 13 SHKURT - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë u ka bërë thirrje shtetasve shqiptarë që të largohen nga Ukraina sa më parë. Në njoftimin për medie kjo ministri ka këshilluar të mos udhëtohet drejt Ukrainës pasi ekziston rreziku për luftë. Ndërkohë, nuk janë dhënë detaje se sa është numri i

shtetasve shqiptarë në Ukrainë. Deri më tani vendet si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Estonia, Suedia, Norvegjia e Holanda u kanë bërë thirrje shtetasve të tyre të largohen nga Ukraina. Në rajonin e Ballkanit, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut u kanë bërë thirrje qytetarëve të vet që përkohësisht ta lëshojnë

Ukrainën. Autoritetet e Kosovës deri më tani nuk kanë bërë ndonjë thirrje të tillë. Më herët, të shtunën, u bë e ditur se Shtetet e Bashkuara do ta evakujnë ambasadën e tyre në Kiev pasi zyrtarët e inteligjencës amerikane paralajmërojnë se një pushtim rus i Ukrainës është gjithnjë e më i afërt.

Masa e re vjen pasi Uashingtoni ka përshkallëzuar paralajmërimet për një pushtim të mundshëm rus të Ukrainës, duke thënë se mund të ndodhë në çdo çast. Një operacion i madh ushtarak kundër Ukrainës mund të fillojë "çdo ditë tani", madje edhe para përfundimit të Lojërave Olimpikë Dimërore, tha më 11 shkurt këshilltari për sigurinë kombëtare i Shtetësisë së Bardhë,

Jake Sullivan. Ai u bëri thirrje të gjithë amerikanëve që të largohen menjëherë nga Ukraina. "Nëse qëndroni, po rrezikoni", tha ai. Rusia ka mohuar se grumbullimi prej më shumë se 100 000 ushtarësh dhe pajisjeve ushtarake në zonat afër kufirit me Ukrainën është paralajmërim për një pushtim të mundshëm.



kohën kur bujqit duhet të blejnë inputet bujqësore", ka vlerësuar Hoti. Nëse subvencionet nuk rriten, sipas ish-kryeministrit, sivjet mund të shohim më shumë tokë djerrë dhe ferma të kafshëve që mbyllen. "Në kontekst të rritjes së pasigurisë në tregjet globale, është e rëndësishë strategjike sigurimi i

një nivel minimal të prodhimit bujqësorë, krahas qëndrueshmërisë së furnizimit me energji që duhet të sigurojë Kosova në afat të gjatë. Këto të dhëna të Agjencisë së Statistikave janë mbledhur sipas metodologjisë së Eurostatit, ku janë përfshirë 77 inpute bujqësore, duke evidentuar çmimet në

barnatore bujqësore, farmaci veterinarë, biznese dhe tregje të ndryshme ku tregtohen inputet bujqësore", ka thënë Hoti. Një ditë më parë edhe njohësit e çështjeve ekonomike në Kosovë i kanë propozuar qeverisë t'ua mundësojë qytetarëve edhe një tërheqje nga Fondi Pensional prej 20-përqindësh. Sipas tyre, kjo do ta

zbuste sadopak situatën e vështirë financiare aktuale si dhe do të ndikonte në rritjen e konsumit dhe ngjalljen e aktivitetit ekonomik te bizneset. Me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, të nxjerrë në dhjetor 2020 nga qeveria e Avdullah Hotit, qytetarëve u ishte mundësuar të tërheqin 10

për qind të kursimeve nga Trusti. Për katër muaj sa zgjati aplikimi, 427 371 veta tërheqën mbi 197 milionë euro. Agjencia e Statistikave e Kosovës ka bërë me dije se çmimet e produkteve të konsumit janë rritur. Rritja më e lartë është vërejtur te buka, drithërat, mishi, qumështi, djathi, vaji, vezët, pemët dhe perimet.

Vazhdojnë rastet e vdekjes dhe infektimit nga Covidi, bëhet thirrje për vaksinim

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se deri më tani në Kosovë janë administruar mbi 1.8 milion doza të vaksinës kundër Covidit. "Sot kemi shënuar mbi 1.8 milion doza të vaksinës anti-Covid të administruara në Republikën e Kosovës, ndërsa gati 900,000 qytetarë janë vaksinuar me të paktën një dozë. Këto arritje kanë ardhur si rezultat i vullnetit të qytetarëve të Republikës për të mbrojtur vetveten dhe të tjerët rreth tyre, si dhe i punës së palodhshme të punonjësve shëndetësorë, për të cilën jemi të gjithë falënderues. Mirëpo, përderisa pandemia ende nuk ka marrë fund, edhe fushata jonë e vaksinimit duhet ende të vazhdojë. Për këtë arsye, kemi pranuar dje një donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës prej 515,970 dozave shtesë; në total arrihen mbi 1 milion vakcina të dhëna nga ShBA. Ky donacion do ta ndihmojë Kosovën që të zgjerojë sa më shumë imunitetin mes popullatës sonë. U jemi përjetësisht mirënjohës ShBA-së dhe aleatëve të tjerë që kanë kontribuar në betejën tonë kundër Covid-19", ka deklaruar Kurti.

Ai përmes një postimi në

llogarinë e vet në "Facebook" u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i marrin dy dozat e para sa më shpejt. "U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të marrin dy dozat e para sa më shpejt. Mbrojtja kundër infektimit, spitalizimit dhe humbjes së jetës bie dukshëm duke filluar disa muaj pas imunizimit me dy dozat e para. Andaj, për ta rifituar imunitetin e plotë duhet të merrni edhe dozën e tretë përforcuese, posa të kalojnë tre muaj pas marrjes së dozës së dytë. Me kujdes të shtuar, bashkë do t'ia dalim", ka theksuar kryeministri Kurti.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se Omicroni po vazhdon të përhapet me shtim të rasteve fatale dhe është varianti dominues në qarkullim duke rënduar situatën epidemiologjike me pasojat të rënda për shëndetin e qytetarëve. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura", ka rekomanduar IKShPK-ja.

Ky institut u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen. "Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-



19, veçanërisht format e rënda të sëmundjes dhe vdekjet, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës nga moshja 12-vjeçare. Vaksinat mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor në komunën tuaj. Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare. Vaksinohuni dhe ftoni të

tjerët të vaksinohen! Duke u vaksinuar vetë, ju mbron veten, mbron edhe njerëzit për rreth jush, në rend të parë familjen", ka njoftuar IKShPK-ja. Kosova ka regjistruar gjashtë viktima dhe 602 raste të reja me koronavirus, njoftoi Ministria e Shëndetësisë të dielën. Rastet e reja dolën pas testimit të 4 386 mostrave, që i bie se 13.72 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me koronavirus. Në raportin e Ministrisë së Shëndetësisë, që iu referohet të

dhënave të 24 orëve paraprake, bëhet me dije se janë shëruar edhe 2 584 pacientë, ndërkaq raste aktive me koronavirus janë 12 651.

Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 810 708 persona.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga moshja 12-vjeçare. Ndërkaq, dozën përforcuese dhe atë të tretë mund ta marrin të gjithë personat nga moshja 18-vjeçare, të cilët para tre muajsh janë imunizuar me dy doza të vaksinës.

Kryetarët e komunave kërkojnë të paguhen sa deputetët dhe ministrat



PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetarët e komunave duhet të paguhen sa deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ministrat. Kjo është kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës që vlerëson se kryekomunarët duhet të vlerësohen për angazhimin e tyre. Po ashtu, kërkesë për rritjen e pagës ka edhe për asamblistët.

Drejtori i AKK-së, Sazan Ibrahim, në një intervistë për "Kosovapres" ka theksuar se

paga për krerët e komunave të Kosovës duhet të rritet për shkak se ata janë në dispozicion të qytetarëve në 24 orë të ditës. "Asociacioni i Komunave të Kosovës vlerëson se projektligji për paga nuk i trajton në mënyrë të dinjitetshme dhe i nënvlerëson kryetarët e komunave. Ne mendojmë që kryetarët e komunave duhet të vlerësohen me një koeficient të barabartë me koeficientin e deputetit të

Republikës së Kosovës apo në nivelin e ministrit sepse kanë jashtëzakonisht shumë përgjegjësi, duke marrë parasysh që janë të zgjedhur të drejtpërdrejtë nga qytetari i Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh se ata janë pothuajse 24 orë përgjegjës për zhvillimet në nivelin lokal, duke marrë parasysh që çdo ditë presin dhe dëgjojnë dhe i zgjidhin hallet e qytetarëve e qe këto dilema nuk i kanë në

nivelin qendror", ka thënë Ibrahim.

Edhe anëtarët e Kuvendeve Komunale, sipas Ibrahimit, përveç pagës, duhet të marrin edhe mëditje në pjesëmarrje në seancat e kuvendeve komunale. "Gjithashtu, anëtarët e kuvendeve komunale në këtë projektligj parashihen të kenë vetëm pagë dhe jo mëditje për pjesëmarrje në seancat e kuvendeve komunale. Duke marrë

parasysh që edhe ata janë të zgjedhur nga qytetarët e Republikës së Kosovës, ne mendojmë që anëtarët e kuvendeve të komunave duhet të kenë edhe një mëditje për pjesëmarrjen në seancat e kuvendeve komunale sepse e meritojnë, sepse edhe ata e përfaqësojnë zërin e qytetarit dhe i mbrojnë interesat e qytetarëve siç i mbrojnë deputetët e Republikës së Kosovës", ka pohuar Ibrahim.

Si të dilet jashtë me “Made in Kosova”?



PRISHTINË, 13 SHKURT - “Doni Fruits” është një kompani e Kosovës, prodhimet e së cilës përdoren në ushqime që përgatiten nga brendet ndërkombëtare. Kjo kompani, e cila veprimtarinë e ka të shtrirë edhe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, merret me kultivimin, grumbullimin, shitjen dhe shpërndarjen e frutave dhe perimeve. “Doni Fruits” është i aprovuar në 77 vende të botës, në të cilat i lejohet të furnizojë ‘Burger King’-un me prodhime. Ne kemi marrë aprovimin nga Gendra e ‘Burger King’-ut në Amerikë”, thotë pronari i kësaj kompanie, Ejup Ahmeti, duke iu referuar zinxhirit amerikan të ushqimeve të shpejta. Furnizimet në dhjetëra vende, si: Gjermani, Holandë, Itali i bën tash e sa vite, ndërsa në të tjera

pret të nisë shpejt. Ahmeti thotë se kompania që drejton është pajisur me disa certifikata ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë, të tilla si: Global G.A.P, ISO 9001 dhe HACCP. Ai thotë se afati i tyre është njëvjeçar. Ekspertët e kompanive që i kanë lëshuar ato bëjnë auditime në tre apo gjashtë muaj. Për të arritur deri këtu, Ahmeti thotë se është dashur shumë angazhim. “Ne kemi disa vjet që jemi fokusuar në sigurinë ushqimore. Çfarë do të thotë kjo? Ne monitorojmë prodhimin. Prodhimet tona janë të sigurta. Në bazë të analizave në fund, prodhimet tona dalin pa mbetje të pesticideve dhe pa mbetje të ndonjë metali të rëndë”, thotë Ahmeti për “Radion Evropa e Lirë”. Kompania “Burger King”, e

themeluar në vitin 1954, është një nga rrjetet më të mëdha të hamburgerëve në botë. Ajo ka hapur pika të shitjes edhe në Kosovë në vitin 2019. Shkumbin Muçolli, menaxher i përgjithshëm i përfaqësisë në Kosovë të “Burger King”-ut, thotë se një nga sfidat më të mëdha për këtë brend ndërkombëtar ka qenë sigurimi i prodhimeve të Kosovës. Por, “pas një procesi shumë të gjatë, kemi arritur që perimet t’i marrim nga një prodhues vendor”, thotë ai. “Ne kemi të licencuar për herë të parë në Kosovë kompaninë ‘Doni Fruits’ që bën furnizimin edhe jashtë Kosovës të ‘Burger King’-ut”, thotë Muçolli. Komisioni Codex Alimentarius, ose CAC, është organi përgjegjës që zhvillon dhe miraton standarde ushqimore, të cilat

shërbejnë si referencë për tregtinë ndërkombëtare të ushqimit. Ky komision mbështetet nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Kosovë janë gjithsej 2 400 kompani prodhuese eksportuese. Megjithatë, Kosova vazhdon të përballet me deficit të lartë tregtar. Sipas të dhënave që ka publikuar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) në dhjetor të vitit të kaluar, eksportet nga Kosova kanë shënuar rritje, por vazhdojnë të jenë shumë të ulëta krahasuar me importet. Sipas ASK-së, eksporti i mallrave në muajin dhjetor ka pasur vlerën e 65 milionë eurove,

ndërsa importi 460 milionë euro.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, eksporti ka shënuar rritje për 39.3 për qind. Sipas ASK-së, vlera totale e eksportit të mallrave gjatë vitit 2021 ka qenë 750 milionë euro. Eksporti i ushqimit dhe kafshëve të gjalla vitin e kaluar ka qenë më i larti në pesë vjetët e fundit. Vlera e eksporteve nga ky sektor më 2021 ka qenë rreth 50 milionë euro. Një vit më herët kjo vlerë ka qenë 41 milionë euro, ndërsa më 2018 rreth 33 milionë euro.

Kosova më së shumti eksporton mallra të përpunuara. Gjatë vitit 2021 shuma e eksportuar e mallrave të përpunuara ka qenë rreth 223 milionë euro. Në anën tjetër, vlera e importit në Kosovë gjatë vitit 2021 ka kaluar 4.5 miliardë euro.

Luftimi i inflacionit, Turqia ul taksat për ushqimet bazë

Ankara, 13 shkurt - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka njoftuar një ulje prej 7-përqindësh në taksat për prodhimet bazë ushqimore, ndërsa vendi përballet me inflacionin jashtë kontrollit. Erdogani tha se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar do të ulej në 1 për qind nga 8 për qind që është aktualisht për ushqimet. Vendimi do të publikohet në gazetën zyrtare dhe do të hyjë në fuqi të hënën. Ai ka shtuar se paralelisht me uljen e taksës, qeveria pret që kompanitë

ushqimore t’i ulin çmimet e tyre 7 për qind. Ai tha se këto produkte ushqimore luajnë rol të rëndësishëm për inflacionin. Të dhënat zyrtare për janarin tregojnë se inflacioni është rritur në nivelin 48.69 për qind në vit, megjithëse ekspertët e pavarur thonë se është realisht mbi 115 për qind. “Nuk do të lejojmë që inflacioni ta shkatërrojë vendin tonë”, tha Erdogan. Kritikët thonë se vendi po vuan nga inflacioni i lartë për shkak të këmbënguljes së zotit Erdogan për t’i ulur normat e interesit. Ai



beson se inflacioni shkaktohet nga normat e larta të interesit, në kundërshti me teorinë

tradicionale ekonomike. Banka Qendrore e Turqisë, pavarësia e së cilës është

zvogëluar nga qeveria, kishte ulur normën bazë të interesit që në shtator. Kriza e monedhës e uli lirën turke në nivelet më të ulëta në muajin dhjetor. Për shkak se Turqia mbështetet tek importet për t’i plotësuar nevojat e saj energjetike, si dhe për materialet bazë dhe furnizimin me shumë prodhime ushqimore, çmimet kanë arritur nivele jashtëzakonisht të larta. Këtë javë lira turke shkëmbehet në nivelin 13.49 me dollarin. Niveli më i ulët i arritur në dhjetor ishte 18.36.

Pushteti korrupcion dhe teori të tjera. Ku gabon psikologjia POP

Pushteti korrupcion, turmat janë të dhunshme dhe depresioni është vetëm një çekuilibër kimik. Apo jo? Teoritë klasike të psikologjisë shpesh kanë një tingëllimë të këndshme, duke krijuar një mitologji që vazhdon në të gjithë median, kinemanë dhe letërsinë. Por studimet e reja po zbulojnë se mendja e njeriut nuk është aq e thjeshtë sa do të donim të mendonim. Kur shfaqen teori tërheqëse në fushën e psikologjisë, ato shpesh marrin vetë udhë. Mjaft të shikoni idenë që oksitocina është 'hormoni i përqaimit'; kjo gjë rrok imagjinatën tonë, por studimet kanë treguar se oksitocina gjithashtu mund të rrisë ndjenjat e intolerancës dhe agresionit. Ne jemi të gjithë psikologë amatorë dhe fusha na ofron një mënyrë tërheqëse për të kuptuar emocionet dhe sjelljen tonë. Nëse mund të konfirmojë besimet tona për natyrën njerëzore, atëherë edhe më mirë. Por, ashtu si çdo shkencë, psikologjia është një proces i rrëmujshëm, i vazhdueshëm dhe shumë rezultate mbresëlënëse nuk janë përsëritur, ose janë shumë më me nuanca nga sa u pa në fillim. Kjo është një renditje e tetë ideve gjerësisht të besueshme të psikologjisë pop, që janë ndoshta të gabuara, ose të paktën tepër të thjeshtuara.

PUSHTETI KORRUPTON GJITHMONË

A e kemi të keqen brenda nesh, apo rrethanat na korruptojnë? Në vitin 1971, psikologu i Universitetit të Stanfordit, Philip Zimbardo, u përpoq të demonstronte fuqinë e mundshme të situatave dhe roleve shoqërore, në korrupcionin e moralit individual. Duke parashikuar skenarët e ëndërruar nga TV Reality dekada më vonë, Zimbardo dhe kolegët krijuan një burg dhe rekrutuan 12 studentë meshkuj në kolegji, për të luajtur rolin e rojeve dhe 12 për të luajtur rolin e të burgosurve.

Ideja ishte të studioheshin ndërveprimet e tyre për dy



javë, por atyre iu desh të ndërprisnin 'Eksperimentin e Burgut të Stanfordit' pas vetëm gjashtë ditësh, të tilla ishin nivelet e mizorisë së shfaqur nga 'rojet' ndaj 'të burgosurve', duke përfshirë detyrimin për t'u pastruar tualetet me duar. Për Zimbardon, mësimi tronditës ishte i qartë: situatat e fuqishme mund të mposhtin individualitetin tonë, duke i bërë njerëzit e mirë, të këqinj. Interpretimi i tij u shoqërua me idetë rreth rrënjëve të së keqes, me sa duket duke ndihmuar për të shpjeguar mizoritë e së kaluarës dhe të së ardhmes. Zimbardo më vonë do të përdorte kërkimin e tij ndërsa dëshmonte në mbrojtje të një prej rojeve amerikane të akuzuar për mizori ndaj të burgosurve në burgun e Abu Ghraib në Irak, në vitet 2003-2004.

Gjatë viteve, studimi i Zimbardos ka qenë subjekt i kritikave dhe riinterpretimeve intensive. Në vitin 2002, psikologët socialë britanikë Alex Haslam dhe Stephen Reicher kryen një eksperiment të ngjashëm të quajtur "BBC Prison Study". Në versionin e tyre, të burgosurit u bashkuan

dhe rrëzuan rojet, duke treguar se ngjarjet e eksperimentit të Stanfordit nuk ishin aspak të pashmangshme. Janë shfaqur edhe pamjet e Zimbardos – në rolin e 'mbikëqyrësit të burgut' – duke udhëzuar rojet e tij se si të sillen, gjë që duket se prish spontanitetin e ngjarjeve që shpallen.

Kohët e fundit, një regjistrim audio zbuloi një nga bashkëpunëtorët e Zimbardos, në rolin e 'gardianit të burgut', duke bindur një nga 'gardianët' që të sillen më mizorisht me të burgosurit. Ai i tha atij se, nëse do të bënte një punë mjaft të mirë, eksperimenti mund të çonte në reformën e burgjeve në jetën reale. Kritikët si Haslam thonë se regjistrimi tregon që studimi i Stanfordit ishte më shumë i ngjashëm me një formë teatri live, sesa një eksperiment shkencor. Zimbardo dhe mbrojtësit e tij kundërshtojnë duke shpjeguar që, pavarësisht nëse sadizmi i rojeve ishte i pashmangshëm apo jo, mesazhi i studimit qëndron – se, në rrethanat të gabuara, njerëzit përndryshe "normalë" janë në gjendje të bëjnë mizori ekstreme.

FËMIJËT ME MË SHUMË VULLNET JANË MË TË SUKSESSHËM MË VONË NË JETË

Në vitet 1960, psikologu amerikan Walter Mischel filloi një seri eksperimentesh ikonike që përfshinin sfida. Disa dhjetëra fëmijë të vegjël duhet të ulen vetëm me një ëmbëlsirë për rreth 15 minuta dhe duhet të rezistojnë ta hanë atë. Shpërblimi i tyre, nëse prisnin, ishte të hanin ëmbëlsirën e parë, plus një tjetër. Studiuesit ndoqën po këta fëmijë në vitet 1980 dhe 1990. Në atë kohë, ata ishin të rritur dhe zbuluan se fëmijët që kishin qenë të suksesshëm në këtë detyrë të 'kënaqësisë së vonuar', më pas kishin ecur më mirë në jetë, për sa i përket rezultateve të provimeve dhe shmangies së telasheve. Rezultatet dukej se sugjeronin se nëse mund t'i mësojmë fëmijët që të kenë vullnet më të fortë, ata do të kenë avantazhe më vonë në jetë.

Megjithatë, psikologët në Universitetin e Nju Jorkut dhe Universitetin e Kalifornisë, Irvine, bënë përpjekjen e parë

të përsëritjes së studimit të ëmbëlsirës në vitin 2018, por këtë herë duke përdorur të dhëna nga qindra fëmijë. Ndryshe nga studimi original, Tyler Watts dhe kolegët e tij kontrolluan gjithashtu një mori variablash sociale dhe të situatave, të tilla si arsimiti i prindërve dhe sa të përgjegjshëm ishin prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Ekipi zbuloi se korrelacioni midis vonësës së kënaqësisë dhe suksesit të mëvonshëm (në këtë rast në adoleshencë), ishte shumë më i dobët sesa në studimin origjinal. Për më tepër, korrelacionet u bënë statistikisht jo të rëndësishme, kur studiuesit faktorizuan në variablat sociale dhe familjare. Interpretimi i Watts dhe kolegëve të tij ishte se aftësia e një fëmije për t'i rezistuar ëmbëlsirave, ka më pak të bëjë me vullnetin e tyre të natyrlshëm. Më shumë kishte të bënte me rrethanat e tyre familjare – për shembull, nëse fëmija kishte mësuar të besonte kur i premtoheshin shpërblime më të mëdha në të ardhmen apo jo. Kjo përkon me një studim tjetër, sipas të cilit të rriturit ia dalin me

objektivat e tyre përmes planifikimit paraprak dhe mangies së tundimit, dhe jo përmes vullnetit brutal.

TURMAT I BËJNË NJERËZIT TË PAMEND DHE TË DHUNSHËM

Tregimet në media për trazirat shpesh nënkuptojnë se një mentalitet i turmës ka dominuar. Raporte të tilla pasqyrojnë një besim të përhapur se kur grupe të mëdha njerëzish mbledhen së bashku, njerëzit humbasin moralin dhe turbullohen me turmën. Në mënyrë të ngjashme, raportet e gazetave për katastrofat shpesh përshkruajnë turmat sikur të jenë të pamend, me raportime për 'stampeda' dhe panik të verbër.

Realiteti, sipas shumë psikologëve socialë bashkëkohorë, është se ka logjikë dhe qëllim për shumë sjellje të turmës. Dhuna nuk është aspak e pashmangshme kur grumbullohen grupe të mëdha – shikoni vetëpërmbajtjen e treguar nga ana e marshuesve amerikanë për të drejtat civile në vitet 1960. Edhe në rastin e rebelëve, megjithëse shpesh mund të jenë të dhunshëm dhe shkatërrues, ata zakonisht kanë një qëllim të përbashkët dhe një ndjenjë të qartë identiteti. Për shembull, gjatë trazirave angleze të vitit 2011, dëmi u drejtua kryesisht ndaj objekteve që shiheshin si simbole të pabarazisë, siç janë dyqanet me çmime të larta. Gjithashtu, nuk ndodhi që kushdo që i shihte trazirat në televizion ose i haste në rrugë, të bashkohej si zombie me 'turmën'. Në vend të kësaj, njerëzit ishin shumë më të prirur për t'u bashkuar në lagjet ku tashmë kishte një ndjenjë të fortë të mohimit të të drejtave.

Është një histori e ngjashme për turmat në raste emergjente. Analiza e ngjarjeve të jetës reale, si fatkeqësia e Hillsborough e 1989-ës dhe mbipopullimi në një koncert në plazhin e Brighton në 2002, sugjerojnë se paniku i verbër është i rrallë dhe se njerëzit shpesh ndalojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin. Kjo sjellje altruiste është ndoshta për shkak të ndjenjës së bashkimit që krijohet, teksa grupe të huajsh kalojnë një përvojë të përbashkët.

TË PARËLINDURIT JANË UDHËHEQËS TË LINDUR

Çfarë kanë të përbashkët Emmanuel Macron, Angela Merkel dhe Boris Johnson? Po Jeff Bezos dhe Elon Musk? Ata janë të gjithë më të mëdhenjtë midis vëllezërve dhe motrave të tyre – duke ofruar dëshmi anekdotike, për të mbështetur idenë popullore se të parëlindurit kanë personalitete të dallueshme që i ndihmojnë të bëhen udhëheqës. Ky arsyetim ka një tërheqje logjike – në fund të fundit, fëmija më i madh gëzon vëmendjen e pandarë të prindërve për një kohë, deri kur lindin fëmijët e tjerë. Sidoqoftë, provat kryesisht nuk e mbështesin atë teori popullore. Në vitin 2015, kur psikologët analizuan me kujdes tiparet e personalitetit të qindra-mijëra njerëzve dhe më pas i lidhën ato me rendin e lindjes së njerëzve në familjen e tyre, nuk u gjetën lidhje të qarta. Një studim i mëvonshëm suedez zbuloi se të parëlindurit kishin më shumë gjasa të përfundonin në role udhëheqëse, por korrelacioni ishte i dobët. Nëse ka një lidhje, atëherë ndoshta ka të bëjë më shumë me mundësinë sesa me aftësinë, si për shembull të qenit personi i zgjedhur për të marrë përsipër biznesin familjar.

DEPRESIONI NDODH PËR SHKAK TË NJË ÇEKUILIBRIMI KIMIK

Ilaçet më të përdorura kundër depresionit rrisin disponueshmërinë në tru të një kimikati të quajtur serotonin. Cilatdo qofshin të drejtat dhe gabimet e ilaçeve (disa i vlerësojnë ilaçet për shpëtimin e jetës së tyre, ndërkohë që kritikët kanë frikë nga mjekimi i tepruar i problemeve emocionale që kanë rrënjë komplekse), përdorimi në rritje i tyre ka ushqyer nocionin se depresioni shkaktohet nga një lloj çekuilibri kimik në tru, që kërkon korrigjim.

Realiteti është se shumica e psikiatërve besojnë që ideja e çekuilibrit kimik është një mbithjeshtëzim. Një pjesë e problemit është se bazohet në logjikë të gabuar. Vetëm fakti që këto barna rrisin nivelet e serotoninës, kjo nuk do të thotë se mungesa e

serotoninës është shkak i depresionit (në fund të fundit, mungesa e paracetamolit nuk shkakton dhimbje koke). Përtej kësaj, studimi pas vdekjes nuk ka arritur të tregojë se njerëzit me depresion kanë nivele më të ulëta të serotoninës dhe studimet që kanë ulur artificialisht nivelet e serotoninës së njerëzve, nuk kanë shkaktuar depresion. E vërteta është se asnjë psikiatër apo neuroshkencëtar nuk mund të thotë sinqerisht se cilat duhet të jenë nivelet e shëndetshme ose korrekte të kimikateve të trurit.

Shumë aktivistë të shëndetit mendor kanë përqafuar idenë e çekuilibrit kimik, duke besuar se kjo do të ndihmojë në uljen e stigmës, duke treguar se depresioni ka një shkak të qartë fizik. Por fatkeqësisht, shpjegimet biologjike të sëmundjes mendore duket se kanë rritur stigmën, ndoshta sepse i bëjnë njerëzit të perceptojnë gjendjen e shëndetit mendor si më thelbësore për të sëmurin, dhe më të vështirë për t'u trajtuar.

NE TË GJITHË KEMI NJË STIL TË PREFERUAR TË TË MËSUARIT

A e keni më të lehtë të mësoni duke lexuar një artikull, apo duke dëgjuar një podcast? Ndoshta preferoni imazhet në vend të tekstit? Sondazhet sugjerojnë se shumica prej nesh besojnë që kemi një "stil të të mësuarit" të preferuar, qoftë ai pamor, dëgjimor, kinetik (të mësosh duke bërë) apo diçka tjetër. Edhe shumica e mësuesve e besojnë. Në fakt, një industri e tërë është krijuar rreth gjetjes së mënyrave për të matur stilet e të mësuarit të njerëzve dhe udhëzimit të mësuesve, se si t'u mësojnë atyre stile të ndryshme. Sidoqoftë, ky është ndoshta shembulli më i qartë, ku ertësia popullore përplaset me shkencën psikologjike. Herë pas here, studimet e kontrolluara me kujdes nuk kanë arritur të gjejnë prova për të mbështetur qasjen e 'stileve të të mësuarit'.

Shumica e studimeve në këtë fushë ndjekin një format të ngjashëm – vullnetarët raportojnë stilin e tyre të preferuar të të mësuarit, dhe më pas disa prej tyre prezantohen me materiale në

modalitetin e tyre të preferuar, ndërsa të tjerë jo. Më pas vjen një provë. Pothuajse çdo studim ka zbuluar se ata që mësojnë sipas stilit të tyre të preferuar nuk performojnë më mirë se një grup që nuk ka mësuar sipas preferencës së vet. Për më tepër, pjesëmarrësit rrallë tregojnë shumë njohuri për stilin e tyre të preferuar të të mësuarit – performanca e tyre është shpesh më e mirë në metodat e tyre jo të favorizuara.

Kritikët e stileve të të nxënit theksojnë se mënyra optimale për të mësuar shpesh varet nga natyra e temës, jo nga preferencat e studentëve. Të tjerë thonë se edhe nëse keni një dobësi në të mësuarit e një mënyre të caktuar, është më mirë nëse mësuesit ju ndihmojnë të përmirësoheni në atë fushë, në vend që ta shmangni atë.

BUZËQESHJA DO JU BËJË TË NDJEHENI MË TË LUMTUR

Rrënjët e kësaj ideje datojnë që nga hipoteza e "feedback-ut të fytyrës", e Çarls Darvinit, e cila sugjeron që shprehja e jashtme e emocioneve mund të japë reagime dhe të ndikojë në ndjenjat tona. Filozofi dhe psikologu i shquar i shekullit të 19-të, William James, propozoi një ide të ngjashme – se janë ndryshimet fizike të lidhura me frikën që të bëjnë të ndihesh i frikësuar, dhe jo e anasjellta.

Këto teori frymëzuan një 'klasik modern' të psikologjisë, botuar në vitin 1988. Studiuesit e udhëhequr nga psikologu Fritz Strack u kërkuan vullnetarëve të shikonin filma vizatimorë, ose duke mbajtur një stilolaps midis dhëmbëve, duke imponuar kështu një buzëqeshje, ose me stilolaps midis buzëve, duke imponuar një vrenjtje. Buzëqeshësit i panë karikaturat më qesharake, duke sugjeruar se thjesht akti i buzëqeshjes mund të ketë një efekt pozitiv mbi ndjenjat. Ky rezultat, dhe ndryshimet e mëvonshme, shpejt i shtynë autorët e ndihmës vetiake të propozojnë që ju të mund të buzëqeshni, për hir të lumturisë më të madhe.

Por në vitin 2016, një kolektiv prej 17 laboratorësh të veçantë kërkimorë rekrutuan afro 2000 pjesëmarrës, në një përpjekje

për të përsëritur studimin vizatimor. Gjetjet ishin jokonsistente nëpër laboratorë, dhe kur ato u grumbulluan së bashku, rezultati ishte negativ – buzëqeshësit nuk ishin më të kënaqur se sa të vrenjturit.

Megjithatë, mund të jetë e parakohshme të fshihet teoria e reagimit të fytyrës. Strack vuri në dukje se përsëritjet moderne i filmonin pjesëmarrësit, ndërsa ai jo, gjë që mund të kishte ndërhyrë në rezultatet, ndoshta duke i bërë pjesëmarrësit të vetëdijshëm. Gjithashtu, gjetjet e tjera të hulumtimit, të tilla si ato që përfshijnë pacientët me Botox, janë në përputhje me hipotezën e reagimit të fytyrës. Trajtimi me Botox ndërhyr në shprehjet e fytyrës dhe ata që e kanë bërë atë, duket se përjetojnë emocione ndryshe nga vullnetarët e tjerë.

OKSITOCINA ËSHTË HOR- MONI I PËRQAFIMIT

Mediat popullore entuziazmohen për oksitocinën, e cilësuar shpesh si "hormoni i dashurisë", veçanërisht rreth Ditës së Shën Valentinit. Është absolutisht e vërtetë që ky kimikat lëshohet në tru kur gratë lindin dhe ushqejnë me gji, dhe gjithashtu kur njerëzit përqafohen dhe bëjnë seks. Kishte gjithashtu studime të kryera në fillim të viteve 2000 që sugjeronin se nuhatja e oksitocinës i bën njerëzit më të besueshëm, bujarë dhe më të ndjeshëm ndaj të tjerëve. Më pas, molekula është konsideruar si një ndërhyrje zbuluese për gjendje të ndryshme, nga autizmi deri te skizofrenia.

Nëse gjithçka tingëllon shumë e mirë për të qenë e vërtetë, kjo ndodh sepse është. Hulumtime më të fundit kanë vënë në pikëpyetje ato gjetje të hershme mbi efektet e kimikatis, si duke dështuar në përsëritjen e tyre, dhe duke treguar një pamje më me nuanca. Për shembull, ndërsa oksitocina mund të rrisë ndjenjat e lidhjes me miqtë dhe familjen, ajo gjithashtu mund të mprehë mospëlqimin për të huajt. Madje mund të rrisë agresionin tek ata me prirje të dhunshme. Me pak fjalë, oksitocina është padyshim një kimikat intrigues, por është shumë më tepër se një hormon përqaftimi.

/ BBC Earth – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Malisheva mposhti Prishtinën, Drita merr kryesim në tabelë

Malisheva e ka fituar ndeshjen kundër Prishtinës kundër 'Liman Gegaj' me rezultat 2-1. Ndërsa Llapi në stadiumin 'Zahir Pajaziti' e mposhti pa problem Ulpijanën, kurse të shtunën Gjilanin ndau pikët me Drenicë. Ky barazim i mundësoi Dritës të ngritet në vendin e parë



mbyll 7:0, teksa tre gola i realizoi Hamdi Namani (4', 29' e 45'), kurse nga një gol e shënuan Marko Simonovski (54'), Arbnor Muja (74'), Almir Kryeziu (81') dhe Ilir Blakqori (87'). Pas kësaj fitoreje, Drita pozicionohet në vendin e parë.

"Epoka e re"

PRISHTINË, 13 SHKURT - Skuadra e Malishevës e ka mundur Prishtinën në stadiumin "Liman Gegaj", me rezultat 2-1. Golin e parë e shënoi Mërgim Pefqeli, në minutën e 75-të, derisa epërsinë në 2-0 e shtoi Ilir Mustafa në minutën e katërt të kohës shtesë. Në anën tjetër, prishtinasit golin e nderit e shënuan në minutën e gjashtë të kohës shtesë nga penalltia, të cilën e realizoi Besnik Krasniqi. Llapi është rikthyer pas një kohe të gjatë në stadiumin "Zahir Pajaziti", ku para ndeshjes me Ulpijanën edhe u përruan punimet e kryera në fushë, e ku tashmë

janë krijuar kushtet tejet të volitshme për futboll. E rikthimi në shtëpi ka rezultuar i suksesshëm për skuadrën e Tahir Batatinës, e cila ka arritur ta mposhtë Ulpijanën, me rezultat 2-0. Golat e fitores për Llapi i shënuan Alban Shillova, në minutën e 53-të dhe Çlirim Avdulli (autogol) në minutën e 63-të. Ndërsa skuadra Gjilani ka arkëtuar vetëm një pikë si mysafire e Drenicës, në Skenderaj, përballje e cila u mbyll me rezultat 1-1, e që skuadrës së Ismet Munishit i kushtoi me humbjen e pozitës së parë. Kuqezinjtë nga Skenderaj kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Kreshnik Uka, në minutën e 25-të, nga një

penallti e akorduar pas ndërhyrjes së VAR-it. Megjithatë, gjilanasit arritën të barazojnë shifrat në minutën e 72-të, me golin e realizuar nga Shend Kelmendi. Ndërkohë, dy skuadrat tjera të kreut të renditjes, Ballkani dhe Drita e kanë nisur furishëm stinorin pranveror. Ballkani në shtëpi e ka mundur Dukagjinin, me rezultat 4-1, me golat e shënuar

nga Meriton Korenica (18'), Armend Thaqi (29), Kushtrim Gashi (63) dhe Mevlan Zeka (84), derisa golin e nderit për skuadrën nga Klina e realizoi Altin Merlaku (80'). Në anën tjetër, Drita ashtu siç pritej ka shënuar fitore të lehtë ndaj Feronikelit, skuadër kjo e cila luan kryesisht me lojtarë të rinj për shkak të krizës financiare. Ndeshja e zhvilluar në Lipjan, u

SUPERLIGA

Malisheva - Prishtina	2-1
Llapi - Ulpijana	2-0
Ballkani - Dukagjini	4-1
Drita - Feronikeli	7-0
Drenica - Gjilani	1-1

TABELA

1. Drita	37 pikë
2. Ballkani	36
3. Gjilani	36
4. Llapi	32
5. Prishtina	24
6. Drenica	24
7. Malisheva	22
8. Dukagjini	18
9. Ulpijana	18
10. Feronikeli	11

Trepça e jashtëzakonshme, triumfon për Kupë

PEJË, 13 SHKURT - Trepça ka mundur Bashkimin me rezultat 76:62 (19:26, 18:10, 16:15, 23:11), duke fituar Kupën e Kosovës në basketboll. Përballja ishte interesante nga fillimi deri në fund. Më mirë ndeshjen e nisën mitrovicasit me epërsi prej dhjetë pikësh 18:8, por nga ky moment prizrenasit hyn në një seri fantastike për të përmbysur rezultatin dhe për të kaluar në epërsi 18:26, kurse çereku i parë përfundon 19:26. "Xehetarët" rikthehen shpejt për të shkrirë epërsinë, e duke pasur katër pikë dallim, 32:28 dhe më pas zhvillohet lojë e barabartë, ku pjesa e parë përfundon 37:36. Perioda e tretë ishte tërësisht e barabartë dhe asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej, duke



bërë që sfida të ishte shumë interesante dhe luftohej për çdo top në parket, kurse rezultati pas 30 minutash ishte 53:51. Por, në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtare, mitrovicasit treguan fuqinë e tyre dhe të përkrahur nga tifozët arritën të shkëputen dhe të

triumfojnë me rezultat 76:62. MVP i turneut është zgjedhur Drilon Hajrizi, çmim të cilin ia ndau djali i të ndjerit Agim Lluka, Rron Uka. Ndërkohë, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ia dorëzoi trofeun e Kupës, kapitenit të Trepçës, Valdrin Haxhiu.

Loriana Kuka fiton medaljen e artë

SARAJEVË, 13 SHKURT - Xhudistja Loriana Kuka ka arritur ta fitojë medaljen e artë në European Open, që është mbajtur në Sarajevë të Bosnjë dhe Hercegovinës. Loriana në finale e mposhti italianen Linda Politi. Kuka në xhiron e parë ishte e lirë,

në xhiron e dytë mposhti me Wazaari dhe Ippon turken, Serdem Daharli. Në çerekfinale Loriana mposhti me Ippon edhe holandezen Lieke Derks. Ajo në gjysmëfinale mposhti me Wazaari në vazhdimë kroatën, Petrunjela Paviq.



Tahiri në top 30-she nga 89 garues në sllallom të madh

PEKINI, 13 SHKURT - Albin Tahiri ka përfunduar në mesin e 30 më të mirëve nga 89 garues në disiplinën e sllallomit të madh, në Lojërat Olimpike Dimërore "Pekini

2022". Skitari ynë arriti një tjetër synim të tij për të hyrë në 30 më të mirët në LOD Pekini 2022, pas vendit të 15-të të zënë në kombinim alpin. Ai zuri vendin e 30-të.

Në lëshimin e parë ishte në vendin e 37-të. Shkaku i kushteve të vështira në shteg shumë garues u diskualifikuan, ndërsa të dyja lëshimet i përfunduan 47

garues. "Jam i lumtur që hyra sërish në top 30, sidomos pasi u lëshova i 73-ti në një shteg tejet të vështirë", ka deklaruar Albin Tahiri, pas garës në sllallom të madh.





SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Administrator i bazave të të dhënave (zyrtar i lartë)
Departamenti:	Teknologjia Informativë
Divizioni:	Teknologjisë Informativë dhe Sistemeve
Grada:	5
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informativë dhe Sistemeve

Administrator i bazave të të dhënave krijon, instalon, konfigurim dhe administron bazat e të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server, dhe ofron shërbime shfrytëzuesve që përdorin aplikacione bankare dhe jobankare.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informativë;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me Oracle dhe Microsoft Support, si dhe kompanitë e tjera që kanë aplikacione dhe baza të të dhënave në BQK;
- Shkruan procedura (Ang. "stored procedures") të cilat përdoren për nxjerrjen e raporteve nga bazat e të dhënave në MS SQL Server dhe Oracle;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të databazave;
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfigurim bazat e të dhënave për "high availability";
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave së të dhënave;
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes së orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri të shkëlqyeshme në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server;
- Njohuri të shkëlqyeshme në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryej rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Shkathësi të shkëlqyeshme në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performancë tuning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL apo PL/SQL;

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diploma bachelor në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Microsoft SQL: MCSA: SQL Database Admin, MCSA: SQL Server, Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP);
- Përvojë 2 vjeçare në administrimin e bazave të të dhënave;
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **28 shkurt 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Administrator baze podataka (viši službenik)
Departament:	Informaciona tehnologija
Odeljenje:	Informacione tehnologije i sistema
Stepen:	5
Izveštava kod:	Rukovodioca Odeljenja Informacione tehnologije i sistema

Administrator baze podataka kreira, instalira, konfigurise i upravlja bazama podataka zasnovanim na Oracle i MS SQL Server, i pruža usluge korisnicima koji koriste bankarske i nebankarske aplikacije.

Odgovornosti i dužnosti rada:

- Administrira baze podataka za aplikacije razvijene u Departman za informacionu tehnologiju;
- Planira stvaranje i održavanje baza podataka. Blisko saraduje sa sistemskim administratorima prilikom instaliranja aplikacija koje se odnose na baze podataka;
- Instalira nove verzije svojih baza podataka i alata, kao i druge alate potrebne za pristup bazama podataka;
- Procenjuje verzije baza podataka, pomoćnih alata, kako bi se osiguralo da baza podataka radi u skladu sa standardima. U saradnji sa drugim administratorima i programerima aplikacija, planira ažuriranja sa minimalnim uticajem na učinke sistema;
- Administrator baze podataka je takođe kontakt tačka sa Oracle i Microsoft Support, kao i drugim kompanijama koje imaju aplikacije i baze podataka u CBK;
- Zapisuje uskladištene procedure (Ang. "stored procedures") koje se koriste za izdvajanje izveštaja iz baza podataka u MS SQL Server i Oracle;
- Piše dokument sa uputstvima za upotrebu baza podataka;
- Reguliše različite probleme u bazama podataka, aplikacijama, komunikaciji između njih i drugim alatima koje korisnici prijavljuju;
- Nadgleda i u slučaju problema rešava probleme u komunikaciji između različitih baza podataka i aplikacija;
- Konfigurise baze podataka za "high availability" - „visoku dostupnost“;
- Kontinuirano planira, sprovodi i testira procedure za izradu rezervnih kopija i obnavljanje baza podataka;
- Izvodi EOD (End of Day) procese nakon zatvaranja rasporeda;
- Obavlja druge zadatke koje mu je dodelio rukovodilac.

Potrebna znanja:

- Odlično znanje u upravljanju bazama podataka zasnovanim na Oracle i MS SQL Server;
- Odlično znanje iz logičkog i fizičkog dizajna baza podataka;
- Sposobnost prilagođavanja u učinku baze podataka;
- Biti u stanju da pruži strategije prilikom izrade baza podataka;
- Odlične veštine pisanja različitih query u skladu sa potrebama i prirodom posla;
- Dobro znanje o upravljanju pravima korisnika baze podataka;
- Iskustvo u migracijama baza podataka;
- Znanje o performance tuning baza podataka;
- Iskustvo u T-SQL ili PL/SQL;

Kvalifikacije i potrebno iskustvo:

- Diploma bachelor u oblasti računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili stručni certifikati za Microsoft SQL: MCSA: SQL Database Admin, MCSA: SQL Server, Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP);
- 2 godine iskustva u administraciji baza podataka;
- Poželjno je engleski jezik.

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije / organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo MONT mora službeno priznati / nostrifikovati;
- Dokazi o identitetu i o stalnom prebivalištu na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Rok za apliciranje je **28. februar 2022**.
- Apliciranje se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Administrator i Sistemeve (zyrtar i lartë)
Departamenti:	Teknologjia Informative
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit
Grada:	5

Administratori i Sistemeve është përgjegjës për administrimin, përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës së sistemeve të teknologjisë informative. Gjithashtu është përgjegjës për sigurinë e informacionit në infrastrukturën e sistemeve.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Konfiguroni, monitoroni pajisjet në infrastrukturë të DTI, përfshirë serverë, storage, switch dhe pajisje tjera përcjellëse,
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban sistemet operative në serverë fizik dhe virtual,
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban sistemet me role të caktuara, siç janë: Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server, etj.
- Administroni infrastrukturën e PKI, përfshirë menaxhimin e certifikatave,
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban replikimet e të dhënave dhe sistemeve në mes dy qendrave.
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban backup-ët e të dhënave dhe sistemeve.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Menaxhon infrastrukturën, duke përfshirë instalimet dhe shpërndarjen e azhurnimeve dhe ndryshimeve përmes Microsoft Endpoint Manager (ish System Center Configuration Manager)
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Konfiguroni, instaloni dhe përditëson softuerët në baza të rregullta në serverët dhe kompjuterët e shfrytëzuesve.
- Bashkëpunon ngushtë me Administratorët dhe teknikët brenda Divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës.
- Trajton dobësitë në infrastrukturë, në aspekt të sigurisë dhe përcjellë log-ët e sigurisë
- Përcjell dhe aplikon standardet e sigurisë së informacionit
- Monitoroni dhe mirëmban sistemin e printimit.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diploma bachelor në shkencë kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit, MCSE ose CompTIA Server+ .
- Përvojë 3 vjeçare në administrim të sistemeve dhe sisteme operative Windows Server 2012 R2, 2016, 2019. Përvojë në sigurinë e sistemeve është e preferueshme.
- Njohuri në menaxhim të DNS, DHCP, PKI.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar.
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **28 shkurt 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



OBJAVLJIVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija:	Administrator sistema (viši službenik)
Odeljenje:	Informaciona tehnologija
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka
Stepen:	5

Administrator sistema je odgovoran za administriranje, poboljšanje i unapređenje infrastrukture sistema informacione tehnologije. Takođe je odgovoran za bezbednost informacija u infrastrukturi sistema.

Radne odgovornosti i dužnosti:

- Vršiti konfiguraciju, praćenje opreme u infrastrukturi DTI-a, uključujući servere, storage, switch i druge prateće opreme,
- Vršiti konfiguraciju, instalira, nadgleda i održava operativne sisteme na fizičkim i virtuelnim sistemima,
- Vršiti konfiguraciju, instalira, nadgleda i održava sisteme sa određenim ulogama, kao što su: Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server, itd.
- Administrira infrastrukturu PKI-a, uključujući upravljanje sertifikatima,
- Vršiti konfiguraciju, instalira, nadgleda i održava replikacije podataka i sistema između dva centra
- Vršiti konfiguraciju, instalira, nadgleda i održava backup-ove podataka i sistema.
- Služi kao drugi nivo obrade incidenta i problema kod svih korisnika informacione tehnologije.
- Upravlja infrastrukturom, uključujući instalacije i deljenje ažuriranja i promena kroz Microsoft Endpoint Manager (bivši System Center Configuration Manager)
- Održava licence i komunicira sa pružiocima spoljnih usluga.
- Vršiti konfiguraciju, instalira i ažurira softvere na redovnim osnovama na serverima i računarima korisnika.
- Blisko saraduje sa administratorima i tehničarima u okviru Odseka i sa službenicima Odseka za bezbednost informacija i kontinuiteta rada.
- Bavi se slabostima u infrastrukturi, u pogledu sigurnosti i prati sigurnosne log-ove
- Prati i primenjuje standarde za bezbednost informacija
- Nadgleda i održava sistem štampanja.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim pripremama i planiranjima IT-a.
- Održava dokumentovanje konfiguracija, stvara procedure i priručnike za sve uređaje i usluge za koje je odgovoran.
- Ostale dužnosti koje mu odredi nadređeni u hijerarhiji Odeljenja za informacione tehnologije.

Kvalifikacije i iskustvo:

- Bachelor diploma u računarskim naukama ili odgovarajući sertifikat koji se odnose na ulogu administratora, MCSE ili CompTIA Server+ .
- Trogodišnje iskustvo u administriranju sistema i operativnih sistema Windows Server 2012 R2, 2016, 2019. Iskustvo u sigurnosti sistema je poželjno.
- Znanje u upravljanju DNS, DHCP, PKI.
- Iskustvo na složenim infrastrukturnim ambijentima IT-a je poželjno.
- Iskustvo ili sertifikat u ITIL je poželjno.
- Poznavanje engleskog jezika je poželjno.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Potvrda o radnom iskustvu izdata od strane nadležne institucije/organizacije podržana potvrdom iz Trusta;
- Uverenje o identitetu i stalnom boravku na Kosovu;

Postupak za apliciranje:

- Poslednji rok za apliciranje je **28. februar 2022**.
- Apliciranje se može uraditi online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi način apliciranja neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpune dokumentacije neće biti razmatrane. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumescdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Afrim Krasniqi B.I. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 71346587 si dhe me nr. fis. 601724611.

► Sanije Hajrizaj-Gecaj, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të Fiziatriis të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovë, me dt. 27.12.2004, nr. KO-01197-01-14.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.